



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

---

Numri i lëndës: 2019:223829

Datë: 21.01.2025

Numri i dokumentit: 06737958

C.nr.1461/17

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, gjyqtari Ibrahim Maloku, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Kompania e Sigurimeve “S.I.V” me seli në ...”, nr...., të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Y.M, zyrtar ligjor pran paditëses, kundër të paditurit A.H nga ..., me objekt të kontestit rimbursim i mjeteve, vlera e kontestit 901.00 €, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor me datën 21.01.2025, në prezencën e të autorizuarit të paditëses e në mungesë të paditurit, në të njëjtën ditë mori dhe përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET e bazuar kërkesëpadia e paditëses Kompania e Sigurimeve S.I.V me seli në ..., ashtu që DETYROHET i padituri A.H nga ..., që në emër të rimbursimit të mjeteve për shkak të humbjes së mbulesës sigurese – pa patentë shofer lidhur me dëmin e shkaktuar në aksidentin e datës 18.09.2015 në ... dhe të paguara palëve të treta të dëmtuara, t’ia paguaj paditëses shumën e përgjithshme në vlerë prej 901.00 € (nëntë qindë e një euro), me normën e kamatës ligjore prej 8 % në vit, duke e llogaritur nga dita e ushtrimit të padisë, dt.09.06.2017, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarrimit.

II. DETYROHET i padituri A.H nga fshati ..., që paditëses Kompania e Sigurimeve S.I.V me seli në Prishtinë, në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore t’ia paguaj shumën prej 20.00 (njëzet) Euro, dhe atë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësja, pranë kësaj Gjykate me dt.09.06.2017, ka parashtruar padi kundër të paditurit, me objekt të kontestit rimbursimin e dëmit. Në referatin e padisë ndër tjera pretendohet që me datë 18.09.2015, rreth orës 16:30, në rrugën “...”, i padituri duke drejtuar automjetin VW Passat me targa 01-459-GM, pronë e A.G., pa poseduar leje të vlefshme për drejtimin e kësaj kategorie të automjeteve, ka shkaktuar aksident trafiku, dhe si pasojë e saj ka shkaktuar dëme materiale në automjetin VW Golf, me targa 01-211-CP, pronë e Autoskollës “Toli”, si dhe nga ky aksident lëndime trupore kanë pësuar Xh.D. dhe F.I.. Ka shtuar se automjeti, shkaktar i aksidentit në

momentin e ndodhjes së aksidentit ka qenë e siguruar tek paditësja. Tutje ka theksuar se mbi bazën e sigurimit të detyrueshëm të autopërgjegjësive, për dëmet e shkaktuara palëve të treta nga përdorimi i mjeteve motorike, paditësja palës së tretë të dëmtuar i ka kompensuar dëmtin material që iu është shkaktuar në automjetin VW Golf me targa 01-211 – CP, gjegjësisht të servisuar tek sërvisi i autorizuar “Te Baci”, në shumën prej 172.00 Euro, si dhe për dëmin material dhe jo material për lëndime trupore që i kanë pësuar Xh.D në shumën prej 529.00 Euro dhe F.I. në shumën prej 200.00 Euro, apo gjithsej shumën prej 901.00 Euro. Po ashtu ka theksuar se meqenëse paditësi ka drejtuar automjetin pa poseduar leje të vlefshme, i njëjti e ka humbur mbulesën siguroese. Nga këto arsye ka kërkuar që të detyrohet i padituri që për shkak të humbjes së mbulesës siguroese – pa patentë shofer t’ia paguaj paditëses shumën prej 901.00 Euro, në emër të shumës së paguar për kompensimin e dëmit palëve të treta të dëmtuara, të gjitha këto me kamatë ligjore duke filluar nga dita e pagësës së dëmit si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore.

I autorizuari i paditëses gjatë seancës përgatitore – shqyrtimit kryesor dhe fjalës përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesës së saj, duke theksuar se i padituri, më datë 08.09.2015, shkaktoi aksident trafikun me dëme materiale dhe jo materiale, duke përfshirë lëndime trupore. Palët e treta, përmes procedurës administrative, kishin paraqitur kërkesë për kompensim dëmi tek paditësja. Sipas ligjit dhe rregullativave në fuqi, si kompani sigurimi kanë kompensuar dëmet si vijon: 901 euro për dëmin material në automjetin Golf me targat 01-211-CP dhe dëmet për lëndimet trupore të Xh.D dhe F.I. Duke qenë se i padituri në datën e aksidentit ishte pa patentë shofer, sipas raportit zyrtar të policisë, pas kompensimit të palëve të treta kanë fituar të drejtën ligjore për të kërkuar rimbursimin e mjeteve, bazuar në Ligjin e Sigurimit të Detyrueshëm nga Auto-Përgjegjësia, Neni 14. Andaj, ka kërkuar nga gjykata që me aktgjykim të aprovojë në tërësi kërkesëpadinë e paditëses si të bazuar dhe të detyrohet i padituri se për shkak të humbjes të mbulesës siguroese pa patentë shofer paditëses t’ia paguaj shumën prej 901.00 euro në emër të pagesës së shumës palëve të treta duke llogaritur kamatën ligjore nga dita e pagesës së dëmit, si dhe shpenzimet e procedurës dhe atë për taksë për padi 20 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Gjykata përmes aktvendimit procedural C.nr.1461/17, të datës 11.06.2024, në mbështetje të dispozitës nga neni 394 të LPK-së, padinë me të gjitha shkresat e bashkangjitura ia ka dërguar të paditurit, në mënyrë që t’i ofrohet mundësia e paraqitjes së përgjigjes në padi brenda afatit prej 15 ditësh, në kuptim të dispozitës nga neni 395 par.1 të LPK-së. Nga shkresat e lëndës rezulton që i padituri Aktvendimin e lartcekur e ka pranuar me datë 26.06.2024, mirëpo nuk ka parashtruar përgjigje në padi brenda afatit të paraparë ligjor.

I padituri A.H ka qenë i ftuar edhe për seancën e datës 21.01.2025, ku ftesën për këtë seancë e ka pranuar me datën 19.11.2024, kurse mungesën nuk e ka arsyetuar. Në prani të këtyre rrethanave duke vepruar sipas propozimit të të autorizuarit të paditëses, Gjykata konform nenit 423 par.4 të LPK-së, seancën e shqyrtimit përgatitor dhe kryesor e ka mbajtur në mungesë të palës së paditur.

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, Gjykata ka bërë administrimin e provave materiale në shkresat e lëndës, dhe atë: Raporti i aksidentit me nr. rastit 2015-AR-2329 dt.18.09.2015, Skica e vendit të ngjarjes me nr.rastit 2015-AR-2329 dt.18.09.2015, kallëzim penal me të nr.rastit 2015-AR-2329, dt.02.10.2015, konfirmimi i sigurimit dt.04.01.2017 lëshuar nga e paditura në emër të A.G., deklarata për pranimin e automjetit nga riparimi dt.16.01.2017 e dhënë nga Xh.D, urdhër pagesa e dëmit TPL materiale dt.27.01.2017 lëshuar nga e paditura, transaksioni bankar dt.27.01.2017, akt marrëveshja për pranimin e vlerës së dëmit material dhe jo material nr.1900/12/2015, dt.29.01.2016, urdhër pagesa e dëmit TPL shëndetësore dt.04.02.2016 lëshuar nga e paditura, transaksioni bankar dt.05.02.2016, akt marrëveshja për pranimin e vlerës së dëmit material dhe jo material nr.192/02/2016 dt.23.02.2016, urdhër pagesa dëmi TPL shëndetësore dt.26.02.2016 lëshuar nga e paditura, si dhe transaksioni bankar dt.26.02.2016.

Pasi që Gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në nenin 8 të LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridike duhet të vendoset si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga raporti i aksidentit, numër rastit 2015-AR-2329, i përpiluar me datës 18.09.2015, si dhe skica e vendit të ngjarjes me numër të rastit dhe datë të njëjtë, vërtetohet fakti se në datën e lartëcekur, rreth orës 16:30, ka ndodhur aksident i komunikacionit në rrugën “Dëshmorët e Kombit” në Prishtinë, deri te i cili aksident kishte ardhur kur vetura A dhe B kanë qenë duke lëvizur nga drejtimi Rrethi i Flamurit në rrugën Dëshmorët e Kombit në drejtim të udhëkryqit tek Posta kryesore, ku vetua A ka qenë duke lëvizur në shiritin e djathtë të rrugës, kurse vetura B në shiritin e majtë të rrugës dhe me të arritur në vendkalimin e këmbësorëve afër Albi Marketit, vetura A ndërmer veprim pa u bindur mirë se i pengon të tjerët ashtu që bën ndërrimin nga shiriti djathtë në të majtë dhe në ato momente me pjesën e përparme të krahut të majtë e godet veturën B, në pjesën e përparme në krahun e djathtë dhe me këtë rast shkaktohen dëme materiale dhe jo materiale, e po ashtu në këtë raport policor si palë të dëmtuara janë evidentuar Xh.D. dhe F.I..

Nga kallëzimi penal me numër të rastit 2015-AR-2329, i datës 02.10.2015, vërtetohet se Policia e Kosovës – Drejtoria Rajonale e Policisë – Njësia Rajonale e Komunikacionit rrugor, kishte ngritur kallëzim penal këtu ndaj të paditurit A.H., për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.1 të KPRK-së, ndër të tjera tek të dhënat personale të të paditurit është dhënë konstatimit se i njëjti nuk posedonte patent shofer.

Nga konfirmimi i sigurimit i lëshuar nga e paditura i datës 04.01.2017, vërtetohet se qytetarja A.G., disponon me mjetin “Passat VW”, të siguruar në Kompanin e Sigurimeve “Sigma”, me numër të policës 0005276950, dhe atë duke filluar nga data 10.11.2014 e deri me datën 10.11.2015.

Nga deklarata për pranimin e automjetit nga riparimi e dhënë nga qytetari Xh.D., vërtetohet se i njëjti si pronar i automjetit Golf V, me targa të regjistrimit 01-211-CP, ka pranuar automjetin në fjalë nga riparimi dhe ka qenë i kënaqur me cilësinë e riparimit të automjetit të bërë tek autoserviti “Te Baci”.

Nga urdhër pagese dëmi T.P.L. Materiale e datës 27.01.2017, vërtetohet se e paditura tek autoservisi "Te Baci", kishte urdhëruar pagesën e shumës prej 172 Euro x TVSH gjithsej shumën prej 202.96 euro, lidhur me mbulimin e përgjegjësisë së të siguarit A.G. Ndërsa nga transaksioni bankar, vërtetohet se me datën 17.01.2017, paditësja ka bërë pagesën në shumën prej 202.96 Euro.

Nga aktmarrëveshja për pranimin e vlerës së dëmit material dhe jo material nr.1900/12/2015, e datës 29.01.2016, vërtetohet se paditësja kishte arritur marrëveshje për kompensimin e palës së dëmtuar Xh.D. dhe atë 350.00 Euro për dëme dhe 179.00 Euro lidhur me shpenzimet e procedurës apo gjithsej shumën prej 529.00 Euro. Kurse nga urdhër pagese dëmi T.P.L. Shëndetësore e datës 04.02.2016, vërtetohet se e paditura tek i autorizuari i palës Xh., av.A.K., kishte urdhëruar pagesën e shumës prej 529.00 Euro, lidhur me mbulimin e përgjegjësisë së të siguarit A.G.. Ndërsa nga transaksioni bankar, vërtetohet se me datën 05.02.2016, paditësja ka bërë pagesën e shumës në fjalë.

Nga aktmarrëveshja për pranimin e vlerës së dëmit material dhe jo material nr.192/02/2016, e datës 23.02.2016, vërtetohet se paditësja kishte arritur marrëveshje për kompensimin e palës së dëmtuar F.I. dhe atë 200.00 Euro për dëme. Kurse nga urdhër pagese dëmi T.P.L. Shëndetësore e datës 26.02.2016, vërtetohet se e paditura tek i autorizuari i palës F.I., kishte urdhëruar pagesën e shumës prej 200.00 Euro, lidhur me mbulimin e përgjegjësisë së të siguarit A. G. Ndërsa nga transaksioni bankar, vërtetohet se me datën 26.02.2016, paditësja ka bërë pagesën e shumës në fjalë.

Në funksion të vlerësimit të bazës ligjore të mbështetjes së kërkesëpadisë, marrë parasysh periudhën dhe natyrën e raportit në mes të palëve ndërgjyqëse, Gjykata vlerëson se fillimisht duhet t'i referohemi Ligjit Nr.04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia (tani e tutje LSDA), i publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 23.06.2011 dhe i shpallur me Dekretin Presidencial të datës 05.07.2011. Dispozita nga neni 1 par.1, e cila i referohet fushëveprimit të ligjit përcakton që: *"Ky ligj rregullon sigurimin nga autopërgjegjësia për dëmet e shkaktuara palëve të treta, që me këtë ligj përcaktohet si sigurim i detyrueshëm"*. Në anën tjetër, dispozita e nenit 14 të të njëjtit ligj, e cila i referohet humbjes së mbulesës siguroese, në paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 përcakton që: *"I siguruari e humbë mbulesën siguroese, kur: drejtuesi nuk ka leje të vlefshme dhe adekuate për drejtim të mjetit motorik, përveç rasteve të përdorimit të mjetit motorik gjatë mësimëve të drejtimit të mjetit nga kandidati, sipas të gjitha rregullave të përcaktuara për procesin e mësimit."*. Tutje, paragrafi 2 i kësaj dispozite përcakton që: *"Humbja e të drejtave nga sigurimi, siç përcaktohen me dispozitat e paragrafit 1. nën-paragrafët 1.1 deri 1.5, të këtij neni, nuk është me ndikim në të drejtën e palës së tretë në dëmshpërblim"*, ndërsa paragrafi 3 përcakton: *"Siguruesi pas përmbushjes së detyrimit nga ky nen dhe paragrafi 3. i nenit 9 të këtij ligji, ka të drejtë të kërkojë rimbursim në procedurë regresi ndaj personit përgjegjës për dëmshpërblimin e paguar, edhe pse personi nuk kishte mbulesë siguroese"*.

Gjykata po ashtu iu referua Ligjit Nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, të publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me dt.10.05.2012, i cili ligj ka hyrë në fuqi 6 muaj

pas datës së publikimit. Dispozita e nenit 960 par.1 e këtij ligji, e cila flet për kalimin e të drejtave të siguruarit ndaj personit përgjegjës për siguresin (subrogimin), përcakton që: *“Me pagimin e shpërblimit nga sigurimi kalojnë në siguresin në bazë të ligjit deri në shumën e shpërblimit të paguar të gjitha të drejtat e të siguruarit kundrejt të gjithë personave, të cilët mbi çfarëdo baze janë përgjegjës për dëmin.”*

Mbi bazën e të gjitha provave të administruara në këtë çështje juridike, për Gjykatën fillimisht u vërtetua pa mëdyshje fakti se automjeti me të cilin ishte shkaktuar aksidenti i komunikacionit, i markës “VW Passat”, me targa të regjistrimit 01-459-GM, ishte i siguruar tek këtu paditësja sipas policës Nr.0005276950, me afat të skadimit deri me datë 10.11.2015. Automjeti në fjalë në momentin e aksidentit ka qenë duke u drejtuar nga këtu i padituri A. H., i cili në momentin e aksidentit është konstatuar se nuk posedon leje të vlefshme për drejtim të automjetit. Konstatimet e tilla janë dhënë në kallëzimin penal me numër të rastit 2015-AR-2329, të datës 02.10.2015 i përpiluar nga Zyrtari Policor B.M.#7969 gjegjësisht tek të dhënat personale të këtu të paditurit ipet konstatimi *“nuk posedon patent shofer”*, ndërsa të gjeturat nga ky kallëzim penal, Gjykata i merr si të mirëqena për faktin se nuk janë kontestuar nga asnjëra prej palëve, e në referim të dispozitës së nenit 329 par.1 të LPK-së, e cila përcakton që: *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të.”*

Një rrethanë e tillë prodhon për pasojë humbjen e mbulesës siguroese, në kuptim të dispozitës nga neni 14 par.1, nën-par 1.2 të LSDA-së. Megjithatë, rrethana e lartcekur, në kuptim të par. 2 të nenit 14 të LSDA-së, nuk ndikon në të drejtën e palëve të treta për të realizuar dëmshpërblim. Referuar kësaj dispozite, sipas kërkesës së palëve të dëmtuara, paditësja rezulton që e ka shpërblyer dëmin i cili ka rrjedhur nga aksidenti i datës 18.09.2015, veprim ky i cili është materializuar përmes urdhër pagesës së dëmit TPL materiale dt.27.01.2017 lëshuar nga e paditura, transaksioni bankar dt.27.01.2017, akt marrëveshja për pranimin e vlerës së dëmit material dhe jo material nr.1900/12/2015, dt.29.01.2016, urdhër pagesa e dëmit TPL shëndetësore dt.04.02.2016 lëshuar nga e paditura, transaksioni bankar dt.05.02.2016, akt marrëveshja për pranimin e vlerës së dëmit material dhe jo material nr.192/02/2016 dt.23.02.2016, urdhër pagesa dëmi TPL shëndetësore dt.26.02.2016 lëshuar nga e paditura, si dhe transaksioni bankar dt.26.02.2016.

Me rastin e përmbushjes së një detyrimi të tillë, palës paditëse i ka lindur e drejta që në kuptim të paragrafit 3 të nenit 14 të LSDA-së, respektivisht nenit 960 par.1 të LMD-së, të kërkojë rimbursim në procedurë të regresit ndaj personit përgjegjës për dëmshpërblimin e paguar, në rastin konkret ndaj palës së paditur. Në prani të këtyre rrethanave Gjykata vlerëson se paditësja është legjitimuar që të kërkojë përmbushjen e detyrimit përmes rrugëve gjyqësore, respektivisht është krijuar marrdhënia e detyrimit mes palëve ndërgjyqëse, në kuptim të dispozitës nga neni 245 të LMD-së, ku parashihet që: *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi në përputhje me përmbajtjen e tij”*. Nga këto arsye është

vendosur sikurse në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi vendosi edhe lidhur me kërkesën akcesore, duke e detyruar të paditurin që shumën e gjykuar nga pika I e dispozitivit të këtij Aktgjykimi, t'ia paguajëpaditëses së bashku me normën e kamatës ligjore prej 8 % në vit, e cila për do të llogaritet nga data e paraqitjes së padisë, datë 09.06.2017, e deri në përmbushjen definitive. Një vendosje e tillë gjen mbështetjenë dispozitën nga neni 382 të LMD-së, e cila parasheh që: *"Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë"*. Gjykata me rastin e përcaktimit të periudhës kohore nga e cila fillon të rrjedhë kamata iu referua Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Nr.265/2020, të dt.02.12.2020.

Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore, nga pika II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, Gjykata e mbështeti në dispozitën nga neni 452 par.1, 454 par.1 lidhur me nenin 463 par.1 LPK-së, duke e obliguar të paditurin që palës paditëse t'ia kompensojë shumën e tërësishme të shpenzimeve të nevojshme në këtë procedurë, në vlerë të përgjithshme prej 20.00 Euro, dhe atë: në emër të taksës gjyqësore për padi.

Mbi bazën e të lartcekurave, në mbështetje të dispozitës së nenit 150, lidhur me nenet 142 dhe 160 të LPK- së, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË  
- Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil -  
C.nr.1461/17, datë 21.01.2025

Gjyqtari,  
Ibrahim Maloku

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi, palët e pakënaqura kanë të drejtën e ankesës në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të të njejtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj gjykate.